



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VAU-DEJES
QENDRA SOCIALE PER TE MOSHUAR "BESA" BARBULLUSH

Objekti : Miratimin e rregullore së brendshme të qendrës Sociale "Besa" Barbullush për vitin 2017.

Baza ligjore; Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005 "Per ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar në Ligjin 121 /2016 " Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë , si dhe në mbështetje të nenit 78, 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

NENI 15 1. Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit ose përfaqësuesit e tij ligjor, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij.

Rregullore e brendshme e strukturave të pranimit.

- ✚ Respekt për të gjithë personat që janë të ndryshëm në besimet fetare, politik, gjuhë dhe etniciteti që ato i përkasin.
- ✚ Pjesëmarrje në aktivitetet e qendrës sociale.
- ✚ Respektimin e orareve të qendrës sociale.
- ✚ Ndalim i daljes jashtë ambientit rrethues të qendrës sociale gjatë orarit të punës.
- ✚ Ndalimin në mënyrë rreptore të pirjes së duhanit apo alkoolit në orarin e punës në ambientet e qendrës sociale .
- ✚ Njoftimin e menjëhershëm në instancat përkatëse për problemet që mund të kenë lidhje me ujin, zjarrin, tërmetet, elektricitetin.
- ✚ Ndalimin e personave të jashtëm për të hyrë në qendrën sociale.
- ✚ Mbikëqyrje të drejtëpërdrejtë të veprimtarive të pranuarve
- ✚ Mbështetje për kujdesin personal të pranuarve.
- ✚ Marrjen e masave që dyert e jashtme të mbahen të kyçura zakonisht dhe merren masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri;
- ✚ Merren masa që muret rrethuese të jenë të sigurta dhe portat e jashtme të ambientit të jenë të kyçura.

- ✚ Të pranuarit nuk lejohen që të dalin jashtë territorit të njësisë pa personin mbikëqyrës, në rastet kur ekspertët e vlerësojnë të nevojshme një gjë te tillë.
- ✚ Inkurajohen që të marrin pjesë në veprimtari dhe programe që nxisin shprehitë për aftësimin e tyre për një jetë sa më të pavarur që të jetë e mundur si udhëtime, lojra, kujdes personal etj.
- ✚ Të pranuarit vendosen në dhomat e gjumit në përputhje me nevojat e tyre, pa cënuar intimitetin e njëri tjetrit.
- ✚ Inkurajimin e përdorimit të hapësirave të përbashkëta ku të pranuarit do të shpenzojnë kohën në veprimtari të sociale, argëtuese.
- ✚ Janë vënë në dispozicion hapësira për vizitat private me anëtarë të tjerë të familjes;
- ✚ Inkurajohen që të shprehin preferencat e tyre për zgjedhjen e ushqimit dhe gatimin e tij.

Aktivitetet dhe objektivat

- ✚ Personat e pranuar jetojnë një marrëdhënie interpersonale.
- ✚ Jeta në qendrën sociale është e determinuar si në çdo familje normale, nga organizimi i gjithë nevojave të gjithsecilit. Realizohen momente loje, argëtimi, kulturore, pushime dhe shëtitje, revizione të jetës komunitare, kultivimin e interesave të veta, i gjithi i raportuar kapacitetit dhe maturimit të gjithsecilit.
- ✚ Të moshuarit zhvillojnë kapacitetet specifike dhe marrjen e vlerësimit për veten. Stafit bëhet baza e tyre e sigurtë me kohëzgjatje terapeutike dhe rehabilituese. Personat e pranuar janë të moshave të treta të cilët kanë gjini , kombësi, kushte personale, patologjie ose problematike dhe vuajtje të ndryshme, për të cilat është e nevojshme një vendosje ekstra familjare e ndryshme nga ajo e origjinës ose prejardhja.

Përbërja e personelit

Personeli i qendrës sociale për të moshuarit përbëhet nga Pergjegjesi, Punonjësit Social, Psikolog, Infermierë ,Kujdestarë , Sanitare , Kuzhinier,Nd/Kuzhiner, Roje.

PËRGJEGJËSI I QËNDRËS

- ✚ Pergjegjesi i qendrës përgjigjet për organizimin dhe zhvillimin e programeve që do të implementohen nga profesionistët, kujdestarët, etj, sipas fushave që mbulojnë për shërbimet që kryejnë me të pranuarit, për procedurat shëndetësore, terapitë e zhvillimit, sigurinë, informimin, mbrojtja nga zjarri, etj.

- ✚ Mbikëqyrjen e personelit e bën drejtuesi i qendrës dhe ofrimi i shërbimit është 24 orë.
- ✚ Stafi i njësisë ka mundësi për të marrë trajnim për fusha të ndryshme në përputhje me nevojat për të realizuar programet e zhvillimit dhe shërbimet e parashikuara.

PUNONJËSI SOCIAL

- ✚ Punonjësi social merr pjesë në veprimtari të ndryshme që mundësojnë zhvillimin e tyre por edhe të argëtohen.
- ✚ Veprimtaritë që do të organizohen të jenë gjithpërfshirëse jo vetëm brënda në qendrën sociale por edhe në aktivitete jashtë saj, me pjesëmarrje edhe nga komuniteti.
- ✚ Në procesin e programimit të veprimtarive merren dhe mendimi, dëshirat dhe ndjenjat e të pranuarve, i personelit dhe i familjarëve. Për të pranuarit me nevoja më të veçantë bëhet dhe vlerësimi i rreziqeve që të sigurohet kujdesi i duhur.
- ✚ Punonjësi social realizon konsultimin me klientët e qendrës sociale.
- ✚ Informon klientet për të gjitha çështjet që lidhen me akomodimin dhe shërbimet që do të ofrohen.
- ✚ Vlerëson gjëndjen social-shëndetësore të klientëve me qëllim që shërbimet të garantojnë mbështetjen dhe progresin e dëshiruar.
- ✚ Për këtë organizohen mbledhje të rregullta me të pranuarit, ndërsa mban lidhje të rregullta me familjarë të tjerë të klienteve.
- ✚ Për probleme njofton menjëherë policinë, kontaktohet familja dhe informohet njësi e zjarrëfikësve apo ekipi i urgjencës.
- ✚ Kontrollon fikëset e zjarrit të cilat provohen rregullisht dhe mirëmbahen si dhe sistemin e spërkatjes me ujë.
- ✚ Mbështet klientet që të praktikojnë zakonet e tyre fetare.
- ✚ Punonjësi social përgjegjës kujdeset për krijimin e marrëdhënieve pozitive me anëtarët e familjes dhe për informimin periodik të tyre.
- ✚ Inkurajon dhe ndihmon të pranuarit që të marrin telefonata nga anëtarë të familjes dhe miqtë e tyre.
- ✚ Ndihmon klientët për të njohur dhe ndjekur procedurat e ankesave që ka përcaktuar drejtoria.
- ✚ Afishon informacion në lidhje me organizata dhe individët, të cilët në mënyrë të pavarur lidhur me ankesat që ata mund të kenë.
- ✚ Ankesat në lidhje me standardet e kujdesit në qendrën sociale, mund t'i drejtohen edhe Komisionit për Inspektimin e Kujdesit Social, Shërbimi Social Shtetëror.

- ✚ Realizon mbledhjet e rishikimit në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara nga drejtoria.
- ✚ Punonjësi social i merr pjesë në mbledhjen e rishikimit dhe harton një relacion me shkrim në emër të njësisë i cili i bashkëlidhet dokumentit të rishikuar.
- ✚ Realizon Planin të Kujdesit të rishikuar.
- ✚ Punonjësi social ndihmon të pranuarin që të arrijë një shkallë sa më të lartë pavarësie që të jetë e mundur deri në kohën që largohet nga struktura e kujdesit.
- ✚ Në kohën e largimit nga komuniteti, hartohet një program i detajuar në përputhje me nevojat e individit të cilat të mund të përmbushen gjatë fazës së adhsme të jetës së tij në familje apo dhe te fatkeqsive natyrore .
- ✚ Në të gjitha rastet, është e nevojshme që procesi i largimit të realizohet nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit të qendrës në bashkëpunim me familjarët.

PSIKOLOGU

- ✚ Realizon vlerësimin në sistem të individit – mënyrën e funksionimit në planin individual, në familje dhe në shoqëri.
- ✚ Evidenton aspektet pozitive, pikat e forta, burimet, mundësitë e individit.
- ✚ Evidenton nevojat, shqetësimet, vuajtjet nëpërmjet analizë motivacionale, emocionale dhe të personalitetit, analizë të marrëdhënieve sociale, analizë të mjedisit social-kulturor-fizik ku jeton individi.
- ✚ Bën në vazhdimësi vlerësimin psikologjik të pacientit. Psikologu punon me individin me qëllim lehtësimin e shqetësimit dhe ruajtjen e funksionimit. Gjithashtu ndihmon në rritjen e aftësive dhe pavarësinë e pacientit, ndërhyrje në situata krize.
- ✚ Harton një plan ditor aktivitetesh për pacientin së bashku me pacientin, . Psikologu ndihmon në hartimin e një plani ditor (aktivizimi në jetën familjare, kalimi i kohës së lirë, pune dhe aktivitete të ndryshme) duke vlerësuar interesat, dëshirat, aftësitë e pacientit.
- ✚ Psikologu së bashku me anetarët e tjerë të ekipit ndihmon në formimin e grupeve të vetë – ndihmës dhe asiston pacientet me qëllim rritjen e aftësive të tyre për vetë – vendosje.
- ✚ Psikologu siguron mbështetje dhe ndihmon antarët e familjes të kuptojnë dhe të përballojnë vështirësitë. Gjithashtu vlerëson marrëdhëniet familjare të pacientit dhe identifikon personat e rëndësishëm për pacientin.

- ✚ Psikologu organizon veprimtari gjithpërfshirëse jo vetëm brenda në banesën sociale por edhe në aktivitete jashtë saj, me pjesëmarrje edhe nga komuniteti.

KUJDESTARËT

- ✚ Në qendrën e të moshuarve kujdestaret zgjedhin të bashkëndajnë drejtpërdrejt jetën me personat e braktisur, të varfër, të mënjanuar, që janë të njohur me këto raste. Në këtë logjikë zgjedhjeje jete ata hapen ndaj mirëpritjes së atyre që kërkojnë dhe janë në nevojë.
- ✚ Të vëndosur si figura referimi mashkullore dhe femërore ndërtojnë raporte të tipit shoke . Nuk është një titull kualifikimi profesional që ata marrin në fushën e kujdesit por një zgjedhje e matur dhe e përgjegjshme duke kryer rolin prindëror në mënyrë afektive, të vazhdueshme, totalisht të disponueshëm dhe të personalizuar. Ky është i pari dhe i vërteti profesion, të cilit i shtohen të gjithë kompetencat e tjera profesionale specifike.
- ✚ Kujdesen për të pranuarit për ushqyerjen , për pastërtinë , për lëvizjen e tyre brenda dhe jashtë qendrës sociale .
- ✚ Ndhijmojnë klientët në proceset jetësore për të arritur një jetesë normale dhe pa probleme .
- ✚ Informon përgjegjësin për probleme të ndryshme .
- ✚ Informon infermierin për probleme shëndetsore .
- ✚ Informon punonjësin social për probleme të ndryshme që mund të ketë si shkak sferat sociale të jetës për mbarëvajtjen sa më normale të saj .

SANITARI

- ✚ Të mbajë pastër ambjentin
- ✚ Të mirëmbajë oborrin e institucionit për të gjithë vitin kalendarik.
- ✚ Në përfundim të ditës së punës dyert dhe dritaret e ambjenteve duhet të jenë të mbyllura.
- ✚ Dritat e godinës duhet të jenë të fikura, përveç dritave që përcaktohen nga drejtuesi i institucionit për efekt ndriçimi gjatë natës.

INFERMIERI

- ✚ Për të gjithë të pranuarit në qendrën sociale plotësohet një skedë e posaçme për gjëndjen dhe nevojat shëndetsore. Informacioni mbi patologjinë e klientit është konfidencial dhe mbahet në një dosje të veçantë dhe përdoret vetëm nga personat e autorizuar si: Stafi përkujdesës apo infermieri.
- ✚ Të pranuarit e vëndosur në qendrën sociale marrin përkujdesin shëndetësor parësor te mjeku i përgjithshëm i lagjes ku ndodhet banesa nën mbikqyrjen e infermierit.
- ✚ Infermieri ndihmon kryerjen e vizitave mjekësore periodike tek profesioniste të fushave të ndryshme ku është i domosdoshëm vizita.
- ✚ Infermieri , inkurajon të pranuarit që të kujdesen dhe të ruajnë gjëndjen e tyre shëndetësore nëpërmjet shërbimeve vetjake, higjienës personale, kujdesit për dhëmbët, marrjes së dietës së nevojshme, etj.
- ✚ Infermieri ndihmon të kuptoj që në strukturat e brendshme të qendrës ndalohet pirja e duhanit, për të mbrojtur shëndetin e klientëve dhe të punonjësve.

Objektivat e shtëpisë

- ✚ Të ofrojë akomodim në përputhje me nevojat e të pranuarve dhe plotësimin e kërkesave të programeve zhvilluese sipas standarteve të miratuara.
- ✚ Të ofrojë një mjedis të sigurtë dhe mbështetës ku dëgjohen dhe inkurajohen që të shprehin nevojat, dëshirat dhe ndjenjat e tyre.
- ✚ Të nxisë mundësitë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.
- ✚ Të nxisë besimin dhe pavarësinë e të pranuarve.
- ✚ Të ofrojë mundësi të bëjnë zgjedhje.
- ✚ Të hartojë programe individuale të kujdesit për të përmbushur nevojat e të pranuarve në përputhje me standartet e miratuara.
- ✚ Të sigurojë një bashkëpunim eficient të personelit të qendrës me familjarët si dhe persona të tjerë.
- ✚ Të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë të gjitha mundësitë me qëllim që të pranuarit të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.

Vlerat e shtëpisë

Qendra ka një numër vlerash që janë të rëndësishme për shtëpinë dhe për të

cilët ofrohet kujdes si:

- ✚ **Dinjteti dhe respekti:** duke njohur vlerën e të pranuarve, veçantinë dhe të drejtën e tyre, personeli i qendrës angazhohet që të trajtohen me dinjtet dhe respekt.
- ✚ **Barazia:** sigurohet duke bërë kujdes që shërbimet në shtëpi të jenë të arritshme dhe të disponueshme për të gjithë. Shërbimi i ofruar nga personeli do të mbështetet në kërkesat e standarteve dhe jo në rrethanat, të kaluarën dhe mënyrën e jetesës së të pranuarve.
- ✚ Shërbimet do të garantojnë mosdiskriminimin për shkak të racës, kulturës, gjuhës, besimeve fetare, gjininë, seksit ose aftësisë ndryshe.
- ✚ Shërbimet do të mbështeten në individualitetin e të pranuarve dhe në përkushtimin, ndershmërinë dhe profesionalizmin e personelit.

- ✚ **Cilësia:** duke nxitur shërbime cilësore që mbështeten në standartet e miratuara dhe përmbushin kërkesat ligjore dhe të praktikës më të mirë të arritur. Angazhimi për të siguruar që stafi që punon do realizojë objektivat e përcaktuara të qendrës në bazë të standarteve të miratuara.

- ✚ **Pavarësia:** duke ju ofruar mundësi të pranuarve që të mendojnë në mënyrë të pavarur, duke siguruar sigurinë dhe intimitetin e tyre gjatë gjithë kohës.

- ✚ **Të drejtat:** qendra angazhohet ndaj të pranuarve për të garantuar të drejtat dhe detyrimet e ligjshme, që parashtrihen në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e njeriut.

- ✚ **Dëgjimi:** Angazhimi për të dëgjuar dhe ndihmuar që të shprehin dëshirat dhe nevojat e tyre në çfarëdo mënyre që i përshtatet më mirë të pranuarve.

- ✚ **Zhvillimi dhe realizimi:** do të inkurajohen për të realizuar potencialin e tyre të plotë dhe do të ndihmohen të realizojnë shpresat dhe ambiciet e tyre për të zhvilluar aftësitë e tyre në jetën e përditshme.

- ✚ **Konfidencialiteti:** I gjithë informacioni personal i të pranuarve do të trajtohet në mirëbesim

8. Proçedurat për zbavitjen

- ✚ Të pranuarit marrin pjesë në veprimtari të ndryshme që të mundësojnë zhvillimin e tyre por edhe të argëtohen.
- ✚ Veprimtari të që do të organizohen të jenë gjithpërfshirëse jo vetëm brenda në qendrën sociale por edhe në aktivitete jashtë saj, me pjesëmarrje edhe nga komuniteti.
- ✚ Në procesin e programimit të veprimtarive merren dhe mendimi, dëshirat dhe ndjenjat e të pranuarve, i personelit dhe i familjarëve. Për të pranuarit me nevoja më të veçantë bëhet dhe vlerësimi i rreziqeve që të sigurohet kujdesi i duhur.

9. Konsultimi me klientët

- ✚ Vlerat dhe filozofia e qendrës sociale kërkon që të pranuarit të jenë të informuar për të gjitha çështjet që lidhen me akomodimin dhe shërbimet që do të ofrohen.
- ✚ Drejtuesit ndihmojnë që të pranuarit, familjarët të marrin pjesë në vlerësimin e gjëndjes social-shëndetësore të klientëve me qëllim që shërbimet të garantojnë mbështetjen dhe progresin e dëshiruar.
- ✚ Për këtë organizohen mbledhje të rregullta me të pranuarit, ndërsa personeli mban lidhje të rregullta me familjarë të tjerë.

10. Proçedurat për përballimin e emergjencave

Qendra sociale angazhohet për ofrimin e një mjedisi të sigurt dhe pa rreziqe. Në rastet e mungesave, do të ndjekë proçedurat e drejtorisë dhe do të informojë menjëherë policinë. Në këto raste kontaktohet familja dhe informohet njësia e zjarrfikësve apo ekipi i urgjencës. Mund të vazhdohet mbikëqyrja e përshtatshme e të pranuarve të tjerë. Stafii i qendrës sociale do të kërkojë menjëherë në zonën përreth.

11. Mbrojtja nga zjarri dhe proçedurat e emergjencës

- ✚ Qendra sociale inspektohet rregullisht nga njësia e shërbimit të zjarrfikësave.
- ✚ Godina e strukturave përmbushë standardet e rregullores kundra zjarrit.
- ✚ Personeli këshillohet vazhdimisht nga punonjësit për parandalimin e zjarrit për proçedurat e mbrojtjes nga zjarri.
- ✚ Në të gjithë ambientet e godinës vendosen fikëset e zjarrit të cilat provohen rregullisht dhe mirëmbahen.
- ✚ Godina pajiset me një sistem të spërkatjes me ujë.

12. Ushtrimi i besimit fetarë

- ✚ Të pranuarit do të mbështeten që të praktikojnë zakonet e tyre fetare.
- ✚ Të pranuarit ndjekin ritet dhe shërbesat fetare.
- ✚ Qendra sociale respekton kërkesat për ofrimin e një diete të përshtatshme nëqoftëse është e nevojshme dhe mbajtjen e veshjeve kur ato kërkohen në raste të tilla.

13. Proçedurat për realizimin e lidhjeve me familjarët

- ✚ Qendra Sociale “Besa” inkurajon ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të të pranuarve me familjarët dhe të afërmit pavarësisht vështirësive që hasen.
- ✚ Punonjësi Social ndërton një plan të veçantë për lidhjet me familjarët dhe të afërmit dhe kujdeset që ata të vizitojnë njësinë sa herë që kjo është e nevojshme.
- ✚ Stafii bën përgatitjet për vizitat në shtëpi duke siguruar shpesh herë transportin e nevojshëm me mbështetjen e personelit.
- ✚ Punonjësit përgjegjës kujdesen për krijimin e marrëdhënieve pozitive me anëtarët e familjes dhe për informimin periodik të tyre.
- ✚ Stafii inkurajon dhe ndihmon të pranuarit që të marrin telefonata nga anëtarë të familjes dhe miqtë e tyre.

14. Proçedurat për trajtimin e ankesave

- ✚ Të pranuarit gjatë gjithë kohës së qëndrimit në qendrën sociale ndihmohen për të njohur dhe ndjekur proçedurat e ankesave që ka përcaktuar drejtoria.
- ✚ Përfituesve dhe kujdestarëve të tyre u jepet kopje të fletushkës me informacion.
- ✚ Njësia afishon informacion në lidhje me organizata dhe individët, të cilët në mënyrë të pavarur lidhur me ankesat që ata mund të kenë.
- ✚ Ankesat në lidhje me standardet e kujdesit në qendrën sociale, mund t’i drejtohen edhe Komisionit për Inspektimin e Kujdesit Social, Shërbimi Social Shtetëror

15. Proçedurat për periudhën kalimtare dhe largimin nga Qendra

- ✚ Qendra sociale ndihmon të pranuarin që të arrijë një shkallë sa më të lartë pavarësie që të jetë e mundur deri në kohën që largohet nga struktura e kujdesit.

- ✚ Në kohën e largimit nga komuniteti, hartohet një program i detajuar në përputhje me nevojat e individit të cilat të mund të përmbushen gjatë fazës së ardhshme të jetës së tij në familje apo dhe te fatkeqsive natyrore .
- ✚ Në të gjitha rastet, është e nevojshme që procesi i largimit të realizohet nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit të qendrës në bashkëpunim me familjarët

**Miraturar nga Kryetari i Bashkisë me
Urdhrin ekzekutiv Nr.17 dt.16.02.2017**